



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
2-0/DPK	01-1557/14
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	Data Datum Date
02	05-05-2014
PRISHTINË	



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.04.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3300/13, për z. Halit Krasniqi – Deputet në Kuvendin e Kosovës, për arsye se i njëjti ka shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3300/13, për zyrtarin e lartë për z. Halit Krasniqi – Deputet në Kuvendin e Kosovës, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat N.P.T.N “Besa”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, zyrtari i lartë z. Krasniqi, fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet, dhe me ndryshimet që duhet t'i bëj për të shmangur situatën e mundshme të konfliktit të interesit. Ai ka konfirmuar se përveç funksionit të deputetit është edhe pronar në biznesin privat N.P.T.N “Besa”.

z. Krasniqi ka kuptuar situatën e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik dhe ka premtuar se do ta autorizoj një person të besueshëm për ta udhëhequr biznesin.

Ndërkohë, z. Krasniqi, ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 1489/14) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka autorizuar një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin në fjalë.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatohet se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

